

Një cigare më pak, shtatë minuta më tepër jetë me Robert Elsie

## KOHA PËR RISHKRIMIN E HISTORISË SË LETËRSISË SHQIPE

*“Dhe unë jam krejt i habitur nga puna që e kanë bërë këta dy veta (Musa Ahmeti dhe Etleva Lala). Kam përshtypjen se bëjnë punë më shumë se sa që është bërë gjatë 50 vjetëve të shkuara në fushën e albanologjisë. Tamam, duhet ta rishkruajmë historinë e letërsisë shqipe. Duhet të rishkruajmë historinë e Shqipërisë edhe për herë të parë kemi njohuri për shqiptarët e periudhës nga viti njëmijë e deri në kohën e Skënderbeut. Është një revolucion edhe vlerat do të përmbysen,” deklaroi Elsie.*

Prishtinë, 29 gusht 2003: Në mesin e albanologëve dhe studiuesve të letrave shqipe nga mbarë bota që këto ditë kishin vërshuar kryeqytetin e Kosovës ishte edhe njeriu me kokë të rruar, i cili me fjalorin e ngadalshëm por të rrjedhshëm të shqipes për shumë kend linte përshtypjen e një shqiptari të ardhur pas shumë kohësh nga kurbeti.

Ai njeri nuk është shqiptar, por kanadezi i pasionuar pas literaturës shqiptare - Robert Elsie, që jeton në Gjermani, për më tepër, është i njohur si një albanolog dhe ambasador i letrave shqipe në botë. Falë punës së tij Kanuni i Lekë Dukagjinit, pastaj shkrimtarët si Fishta, Camaj, Kadare, De Rada e shumë shkrimtarë të tjerë tashmë flasin në gjuhën gjermane dhe angleze.

Robert Elsie i ardhur për të përcjellur punimet e seminarit të 22-ta me radhë, për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare këtë vit, nga presidenti i Kosovës, dr. Rugova, mori çmimin e artë të LSHP-së, ndërsa të dielën u kthye në Gjermani me rreth 50 kilogram libra në gjuhën shqipe. Librat i duhen sepse është duke e përgatitur një vepër për Kosovën. Është fjala për një Leksikon të Kosovës. Ndërsa leksikonin për Shqipërinë në rreth 500 faqe e ka në botim, leksikoni për Kosovën do të jetë leksikoni parë i një shteti që nuk është shtet. Vetë Elsie beson se Kosova do të jetë shtet.

Robert Elsie pranoi të jap intervistë për “Kohën Ditore” me një kusht nëse pyetjet do të jenë interesante, prandaj pyetja e parë ishte se nëse Elsie kishte ndonjë ide se për çfarë mund të bisedonim. Ai u qesh dhe tha: mund të bisedojmë për shumë gjëra, por megjithatë gazetari duhet drejtuar bisedën.

Elsie Seminarin e konsideron më tepër si një pikë takimi, një burim frymëzimi për albanologët. Ata takohen për më shumë se dhjetë ditë në Prishtinë, flasin me njëri tjetrin, lexojnë veprat e njëri tjetrit, si dhe marrin, të paktën, informacione për zhvillimet e fundit në këtë lëmi. “Për mua është një burim frymëzimi. Nuk është një vend ku unë mësoj shumë gjëra, por janë me interes të madh kontaktet,” deklaroi Elsie.

I pyetur se po të ishte shqiptar, si do t’ia dilte? ai reagoi: si shqiptar i Shqipërisë apo i Kosovës? Zgjidhni! Elsie shtoi: “Unë do të jetoja me shumë frustracion. Ndoshta do të çmendesha. Nuk kam përshtypjen që do mund të jetoja në botën shqiptare. Jam një njeri pakëz si i brishtë dhe duhet të kesh shumë forcë për të jetuar si shqiptar, me shqiptarët.”

### **Nuk ka përkthyes, nuk ka përkthime, nuk ka letërsi**

Për punën që e bën Elsie si përkthyes i veprave shqipe në gjuhë të huaja, kryesisht në anglisht, ai u përgjigj se nuk ka ndonjë levërdi personale. “Benefecione materiale nuk ka fare. Unë kam botuar 25 libra, ndoshta 30 dhe, për asnjë libër nuk kam marrë asnjë fitim. Në to kam investuar vet. Mirëpo, është kënaqësia ajo që më shtyn të merrem me këtë punë. Albanologjia është një fushë që nuk është prekur shumë. Botojnë shumë njerëz, por nuk ka shumë botime me

cilësi të lartë. Nuk dua të zëvendësoj punën e shkencëtarëve shqiptarë që punojnë në lëminë e albanologjisë, dëshiroj vetëm që ta prezentojë botën shqiptare jashtë me botime në anglisht dhe në gjuhë të tjera.”

Por, megjithatë, letërsia shqipe është pakëz e përfaqësuar në botë, ose pse ajo është e dobët, ose pse nuk ka prezentim të mirë, ose pse bota nuk është e interesuar për letërsinë shqipe? Elsie e vë theksin te mungesa e përkthyesve dhe përkthimet.

“Ka një arsye të thjeshtë; letërsia shqiptare është e panjohur, e në letërsinë shqipe ka gjëra të mira e me vlera, por edhe të dobëta si në çdo letërsi. Por ka një mungesë përkthyesish. Letërsia shqipe njihet vetëm nëpërmjet përkthimit. Ka shumë pak përkthyes të letërsisë shqipe në anglisht, gjermanisht, frëngjisht, rusisht dhe në gjuhë të tjera. Prandaj ka një barrierë, një mur, që e ndanë letërsinë shqipe nga bota e jashtme. Pra, nuk lexohet, domethënë nuk kuptohet sepse mungojnë përkthimet,” përgjigjet ai.

Elsie është përkthyes i pesë këngëve të para të veprës “Lahuta e Malcis” së Gjergj Fishtës. Se a do ta lexojë një kanadez eposin shqiptar, Elsie përgjigjet pozitivisht. “Mund të mos ketë shumë interes për një epikë. Epika është një lëmi e letërsisë që nuk lexohet shumë, por njerëzit që kanë interes për letërsinë dhe kulturën shqiptare do ta lexojnë me gjithë qejf, jo vetëm nga ana letrare, por edhe nga ana e njohjes sa më të mirë të kulturës shqiptare.”

## **Dy anët e medaljes së Kanunit të Lekë Dukagjinit**

Si botuesi i Kanunit në gjermanisht, Elsie thotë se është një ndër veprat më të kërkuara jashtë, të ardhura nga bota shqiptare. Ndërkohë që Kanuni sipas sondazheve të kohëve të fundit paraqet një bestseller të llojit të vet në Kosovë, edhe atë falë botimeve në anglisht dhe gjermanisht.

“Kanuni tani është një libër që njihet jashtë. Ka një botim shumë të bukur në anglisht. Unë e kam botuar versionin në gjermanisht, ndërkohë edhe versioni në frëngjisht ka dalë. Është i përkthyer gjithashtu në italishte, dhe tani është duke u përgatitur një version në spanjisht. Kështu, që Kanuni është diçka që njihet dhe është karakteristike për kulturën shqiptare të veriut,” përgjigjet Elsie.

Për këtë libër jashtë ka një interes të shtuar sepse në libër flitet për kulturën, traditën pastaj për gjakmarrjen dhe vrasjet që nuk kuptohen nga të huajt. “Në botën e jashtme është krijuar mendimi që Kanuni jep shpjegim për shumë gjëra. Kanuni jep shpjegim për disa gjëra, por jo për të gjitha,” mendon Elsie. Ai e merr një shembull, të para një muaji, kur atë e ka kontaktuar shefi i degës së policisë së një qyteti gjerman, që donte të kuptonte nivelin e lartë të kriminalitetit të shqiptarët në Gjermani. Shefi i policisë mendonte se burimi i këtij kriminaliteti ishte fakti që shqiptarët kishin një kulturë ndryshe, dhe për kod, ende po përdornin Kanunin. “Ai kërkonte ta lexonte botimin tim për të mësuar më shumë për këtë dukuri. Unë i thashë: ‘Nuk besoj se do të gjeni atë që kërkoni, sepse kriminalitet ka jo vetëm në Shqipërinë e veriut por edhe në Shqipërinë e jugut. Në këtë aspekt nuk ka dallime. Pra, në Gjermani ka shqiptarë nga vise të ndryshme të Shqipërisë. Mandej në Gjermani ka dhe jetojnë edhe shumë njerëz të mirë që vijnë nga veriu dhe nga jugu. Nuk besoj që ‘Kanuni’ ju ndihmon për të kuptuar sjelljet e këtyre hajdutëve që përmenden në Gjermani,’” i kishte thënë Elsie zyrtarit policor. Nëse Kanuni është përfytyrimi më i plotë që kanë krijuar të tjerët për shqiptarët, Elsie beson se ai është vetëm njëri prej elementeve.

## **Musa Ahmeti dhe Etleva Lala kanë bërë më shumë se të gjithë albanologët gjatë 50 vjetëve të fundit**

Në Seminar gjatë orës së ligjëratës së Musa Ahmetit, zbuluesit të dorëshkrimit më të vjetër në shqip, ishte i pranishëm edhe Elsie, i cili në fund të orës tha se është fjala për një revolucion.

Për “Kohën Ditore” Elsie dha disa shpjegime shtesë në lidhje me atë se për çfarë revolucionin është fjala. Elsie beson se jemi në prag të një revolucionin në lëminë e albanologjisë, në disa kuptime, me zbulime të reja të fundit të Musa Ahmetit dhe Etleva Lalës. Sipas këtyre shkencëtarëve, gjejmë se ka shumë tekste të pazbuluara në gjuhën shqipe. Teksti më i njohur është dorëshkrimi i gjatë i Teodor Shkodranit për të cilin është folur shumë, e njihet pak, sepse ende nuk është botuar. Por ka edhe vepra të tjera të zbuluara. “Dhe unë jam krejt i habitur nga puna që e kanë bërë këta dy veta. Kam përshtypjen se bëjnë punë më shumë se sa që është bërë gjatë 50 vjetëve të shkuara në fushën e albanologjisë. Tamam, duhet ta rishkruajmë historinë e letërsisë shqipe. Duhet të rishkruajmë historinë e Shqipërisë dhe, për herë të parë, kemi njohuri për shqiptarët e periudhës nga viti njëmijë e deri në kohën e Skënderbeut. Është një revolucion dhe vlerat do të përmbysen,” deklaroi Elsie. Një gjë tjetër që i ka rënë Elsi në sy është se në kohën kur të gjithë flasin se mund të ketë e mund të mos ketë tekste të vjetra, tashti ndodhë që në mes të Tiranës të gjenden tekste të vjetra e të pazbuluara në gjuhën shqipe.

“Ku janë shkencëtarët e Tiranës, ku kanë qenë gjatë 50 viteve, kur këto tekste ndodhen në arkivin e shtetit të Tiranës? Dhe vjen një njeri nga jashtë, nga Zagrebi, z. Ahmeti, dhe ai i zbulon aty. Kjo thotë shumë për gjendjen e albanologjisë në Shqipëri,” përgjigjet dhe shtron një dilemë Robert Elsie.

Sa i përket debatit rreth gegnishtes dhe gjuhës standarde të shqipes, Elsie theksoi se kjo është një çështje që i përket shqiptarëve dhe se nuk dëshiron të përzihet në këtë çështje. Por, megjithatë, mendimi i tij është se duhet të ketë më shumë liri. “Unë jam vetëm kundër një gjëje. Unë jam kundër një nivelizimi artificial dhe të përforcuar të gjuhës. Unë nuk dua të shoh një kohë kur të gjithë shqiptarët flasin njësoj, me theks të njëjtë duke përdorur fjalët e njëjta, duke shprehur mendime të njëjta. Unë dua të shoh një laramani në botën shqiptare, në pikëpamje kulturore, letrare dhe gjuhësore. Shqetësimi im është se, mos arrijmë në një fazë ku do të mësohet vetëm një gjuhë standarde dhe të ndëshkohet çdo njeri që flet ndryshe,” tha Elsie, i lutur për të shfaqur mendimin e tij, ndërsa shtoi se kultura gege është një kulturë që duhet respektuar, por përsëriti se duhet të ketë më shumë liri.

### **Kadareja si një shkrimtar i klasit botëror**

I pyetur për Kadarenë nëse ai ishte një disident, konformist, oborrtarë apo thjesht një shkrimtar, Elsie u përgjigj se ndoshta z. Kadare këtë punë e di më mirë. Por shtoi se e ka lexuar debatin dhe se e njeh mirë nga veprat e tij. “Me sa e njoh, kam përshtypjen se Kadareja ishte më shumë disident, por jetonte në një sistem që nuk lejonte disidencë. Pra, në veprat e tij ka shumë gjëra që për botën shqiptare në atë kohë ishin disidencë. Sot, kur e lexojmë, ato nuk bien shumë në sy, por për lexuesin e para njëzet viteve në Shqipëri çdo vepër e Kadaresë ishte një vepër disidencë,” tha ai.

Elsie thotë se Kadarenë e ka lexuar me shumë interes. “Kur veprat dolën në Tiranë, u shitën menjëherë, jo vetëm për cilësinë letrare por edhe për pikat e vogla të disidencës që kishin brenda. Për shembull; Kadareja mund të ketë përmendur ndonjë shkrimtar të para Luftës së Dytë Botërore, mund të ketë sharë për të botuar librin, por vet fakti që ai kishte përmendur këta shkrimtarë ishte pakëz disidente nga ana e tij. Është punë e shkencëtarëve të tjerë shqiptarë që të bëjnë hulumtime, të gjejnë në çfarë masë ishte konformist, disident apo tjetër,” është vlerësimi i tanishëm i Elsi për Kadarenë. Po, a është Kadareja shkrimtar i klasit botëror? “Po. Ka disa vepra të klasit botëror. Ka disa vepra shumë të mira. Pa dyshim.”

Robert Elsie ndërkohë që, ka shumë projekte, plane, përkthime në dorëshkrime, në listën e të përkthyerve figuron edhe emri i poetit kosovar, Azem Shkreli. “E zgjodha Azem Shkrelin si një përfaqësues të një kulture të përzier kosovare. Azem Shkreli ishte një poet, një shkrimtar

intelektual, i qytetit. Në anën tjetër ishte një poet rugovas, i malësorëve. Bashkimi i këtyre dy botërave më ka interesuar dhe doja të shihja në çfarë mase ai mund të bashkonte këto dy botëra, prandaj jam marrë me te,” tha, i palodhshmi Robert Elsie. Por, ai nuk është i sigurtë nëse do t’i botojë ato poezi, sepse ai duhet ta lexojë përkthimin edhe një herë, pas disa muajve pushimi. Kur Elsie e bën një përkthim, e lë dorëshkrimin të pushojë, dhe pas një kohe përsëri e lexon. Nëse prap i pëlqen, ai do ta botojë, e nëse jo, do ta futë në sirtar dhe do të rrijë aty njëzet vjet.

E, ky është Robert Elsie, kjo është mënyra e tij e punës dhe e zgjedhjes, e njërit nga personalitetet e rralla që ka bërë më së shumti që letërsia dhe kultura shqiptare të njihet në botë dhe, më në fund, të zë vendin e vet në letërsinë e përbotshme. Si antiduhanxhi, ai ka kohë edhe të këshillojë se një cigare kushton me shtatë minuta jetë.

Intervistoi: Mentor Haliti.

[botuar në gazetën *Koha Ditore*, Prishtinë, e hënë, 1 shtator 2003. Published in the newspaper *Koha Ditore*, Prishtina, Monday, 1 September 2003.]